




**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**

**KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE**



Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së dytë - II - të, të rregullt të Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 01.03.2021, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Vjollca Konjusha - Kryesuese e Kuvendit të Komunës, Remzi Shala, Arjeta Jashari, Mirvete Gërguri, Jetmir Berisha, Albert Jasharaj, Miranda Shabani, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Ali Zogjani, Durim Hajra, Doruntina Jashari, Eglantina Azemi, Aida Alimi, Arjana Zogjani, Naser Graiçevci, Migjen Kolshi, Driton Ademi, Ali Ismaili, Driton Hasolli, Mehdi Lahu, Shaban Ademi, Mensur Graiçevci, Hysni Hasani, Suhat Ademi dhe Ljubisa Qirkoviq.

Mungon: Ilir Hasani.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Fadil Krasniqi - Nënkryetar i Komunës, Afrim Krasniqi - Drejtor i Administratës, Mehmet Gërguri - Drejtor i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ekrem Berjani - Drejtor i Zhvillimit Ekonomik, Jakup Dumani - Drejtor i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e Shoqërisë Civile.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 24.12.2020.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Raporti vjetor i punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës për vitin 2020.
4. Propozim për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake për vitin 2020.
5. Propozim për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2020, për shpenzim në vitin 2021.
6. Shqyrtimi i dytë i 'Propozimit për taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënimit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës për vitin 2021'.
7. Shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtimin e vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sipas shkresës Nr. 020-995/5, të datës 09.02.2021.
8. Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në mbledhjen e sotme dhe hapi diskutimin.

Driton Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në rendin e ditës kemi një mospërputhje lidhur me dy pika: Propozimin për rritjen e buxhetit komunal nga të hyrat vetjake për vitin 2020 dhe Propozimin për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2020, për shpenzim në vitin 2021. Të gjithë ne e dijmë se disa procedura për shpenzimin e buxhetit, fillojnë në muajin maj dhe përfundojnë në muajin tetor, por ju po ashtu duhet ta dini, pse po ndodh bartja e shumës së mjeteve financiare prej: 157,000.00€, ju aty e cekni arsyet e bartjes si: zbatimin e memorandumit për zjarrëfikës në shumë prej: 10,000.00€, të cilin ne nuk e kemi, pastaj shuma prej: 100,000.00€ për administratën e shëndetësisë, specifikohet se shuma prej: 60,000.00€, ndahen për harmonizimin e pagave për punëtorët shëndetësorë të Karitasit për vitin 2021, ndërsa pjesa tjetër shuma prej: 40,000.00€ duhet të shpenzohet për pandeminë e Covid - 19, nuk ka asnjë sqarim për çka do të shpenzohen këto mjete financiare. Te pika e pestë janë mbi 700,000.00€, që janë pjesë e projekteve me Kornizën Afatmesme Buxhetore, këto mjete mund të vendosen vetëm në rishikimin e buxhetit për vitin 2021, ky propozim duhet të konsolidohet dhe rregullohet sipas ligjit dhe rregullave, ose përndryshe ne nuk marrim pjesë në debat për këtë pikë.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Nuk dua të përsëris çështjen e sqarimit dhe rregullsisë së propozimeve, për dy pika të rendit të ditës që u ngritën nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Driton Ademi, ne po ashtu jemi pajtuar që në çdo mbledhje ta kemi një 'Informatë të shkurtër për menaxhimin e pandemisë Covid - 19 në Komunën e Fushë-Kosovës' dhe ajo nuk është në rendin e ditës.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar për mbledhjen e sotme.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota 'për', një 'kundër' dhe një abstenim, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 24.12.2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 24.12.2020, nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim për diskutimet tuaja.

Durim Hajra: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ne votojmë kundër lidhur me 'ekstraktin e procesverbalit', për arsye të mospublikimit të audioincizimit të mbledhjeve, ndërsa vërejtje në përmbajtjen e tij nuk kemi. Shpresojmë që këtë vitë do të filloni me publikimin e audioincizimeve.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Informimi i publikut është bazamenti i demokracisë, në opinion nuk ka informata për punën tonë, ne këtu jemi duke bërë monolog me njëri-tjetrin, në këtë rast humb roli i anëtarit të Kuvendit të Komunës. Unë e uroi Lëvizjen Vetëvendosje dhe qytetarët e Kosovës për zgjedhje të lira.

Pas që diskutime tjera nuk pati lidhur me përmbajtjen e ekstraktit të procesverbalit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 24.12.2020.

U votua me: dymbëdhjetë vota 'për', dhjetë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e dy anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datën 24.12.2020.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të parashtrajnë për Ekzekutivin e Komunës nëse kanë ndonjë pyetje.

Durim Hajra: Unë i kam disa pyetje që duhet t'i përsëris prapë, meqë nuk kam marrë përgjigjeje. Për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, fjala është për rrugën 'Imer Prizreni', jo larg objekteve të KEDS-it në Fushë-Kosovë, e cila nuk është kthyerë në gjendjen e mëparshme dhe rruga 'Aziz Zhilivoda' e cila po ashtu ka shumë dëmtime të cilat nuk janë të riparuar, unë pyes, pse nuk janë marrë hapat e nevojshëm për rregullimin si duhet të këtyre dy rrugëve? Ndriçimi publik në fshatin Vragoli, ka pasur pengesa dhe nuk ka funksionuar për disa ditë radhazi, aty po ka probleme të vazhdueshme. Pengesa të njëjta po ka edhe në fshatin Harilaç, ku banorët po kanë problem edhe me rrjetin elektrikë. Disa familje të Statcioni i trenit nuk janë të kyqura në rrjetin e kanalizimit, ata kanalizimin e kanë me gropë septike? Na duhet ta përsërisim edhe pyetjen për problemin e furnizimit me ujë të pijëshëm nëpër fshatra, problem kanë banorët e fshatit Sllatinë e Madhe. Për Drejtorinë e Planifikimit Urban, e kemi një pyetje ku rruga 'Xhemajl Mustafa', nuk është asfaltuar sipas projeksioneve të parapara me projektin për asfaltimin e kësaj rruge? Gjithëashtu Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik nuk e ka publikuar listën për përfituesit e bizneseve të vogla në Komunën e Fushë-Kosovës. Pyetja tjetër ka të bëjë me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kur do të bëhet funksionalizimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare në lagjen e Dardanisë, apo e njëjta do ta përjeton fatin e Ambulancës së Mjekësisë Familjare në atë zonë. Kryetari i Komunës e ka paraqitur si mega projekt me Ministrinë e Infrastrukturës, asfaltimin e rrugës në fshatin Miradi e Epërme, mirëpo ka kaluar tani një vitë dhe atje rruga është në gjendje të keqe. Pyes se kur do të përfundon ky projekt publik për asfaltimin e rrugës?. Nëse ka probleme me shpronësimin e pronave kjo duhet të thuhet dhe të kryhet si punë paraprake.

Arjeta Jashari: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Familja Jashari ka problem me rrjetin e kanalizimit dhe kjo punë nuk është rregulluar për pesë vite, andaj kërkojmë nga autoritetet përkatëse që ta bëjnë rregullimin e këtij rrjeti të kanalizimit në gjatësi prej 150 metra deri në rrugën kryesore, kjo është një shqetësim për banorët e lagjes.

Migjen Kolshi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë nuk kam marrë përgjigje nga ju z. Nënkryetar i Komunës, për tenderin për bllokimin dhe zhvendosjen e automjeteve me marimangë nga 'Sh.p.k Dreni'. Po ashtu, nga Drejtoria për Inspektorat nuk kemi asnjë përgjigje lidhur me

objektin përballë komunës, të cilit nuk i është ndalur puna nga Inspektorët e Ndërtimit. Lidhur me ndriçimin publik në fshatin Harilaç, problemet me energjinë elektrike, kanë ardhur si rezultat i ngarkesave nga ngrohja qendrore me rrymë nëpër shtëpitë e banimit, ndriçimi publik tani është rregulluar.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Më në fund mikrofonat janë rregulluar në sallën e Kuvendit të Komunës dhe kjo punë është e mirë. Unë nuk kam marrë përgjigje për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi lidhur me dukurinë e vjedhjeve, nëpër shtëpi të banimit në territorin e komunës, për këtë çështje nuk kemi marrë asnjë përgjigjeje, andaj pyes pse nuk po mblidhet Këshilli për Siguri?

Eglantina Azemi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kërkojmë që Biblioteka në Fushë-Kosovë të jetë funksionale, ose aty të ndërtohet një objekt i ri për këtë qëllim.

Driton Hasolli: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Rruga 'Marin Barleti' në fshatin Bardh i Madh është dëmtuar në masë të madhe, kërkoj që kjo rrugë të asfaltohet

Ali Ismaili: Unë kërkoj që barnatorja e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, të funksionon edhe pas orës tre, të ketë furnizim më të mirë me barna, sepse janë ndarë shumë mjete financiare. Unë vetë dje kam dalur për një amoksikllab jashtë, nëse është ky bari aty, njerëzit në nevojë duhet ta kenë mundësinë ta marrin, i kemi 45 punëtorë të Karitasit, duhet ta gjejmë një zgjidhje për këtë problem, duke marrë parasysh faktin se një pjesë e popullatës janë në gjendje të vështirë ekonomike dhe sociale

Shaban Ademi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Shtabi Emërgjent i Komunës dhe Qe Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, duhet ta kenë një kordinim, mjekët aty e kryejnë punën e tyre, por disa raste të caktuara, kanë nevojë për ndihmë shtesë, andaj duhet të kemi kujdes. Unë dua ta potencoi rastin e një familje me tre të sëmuar, që nuk i është ofruar ndihmë ushqimore nga komuna dhe ata kanë qenë në gjendje të rëndë shëndetësore, për arsye etike nuk dua ta përmendi me emër, por mund ta merrni emrin dhe ta verifikoni. Raste të tilla në komunë ka shumë, ne i kemi ndarë 1.1 milion euro, njerëzit duhet të përkrahen në kohën e vështirë për familjet e tyre, kjo punë e don një angazhim shtesë.

Sabit Bullatovci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam vetëm një kërkesë të banorëve të fshatit Miradi e Poshtme për problemin e nënkalimit, aty tani ka shumë ujë, rruga magjistrale M9 është ndërtuar në vitin 2010 dhe që nga atëherë, ne kemi shumë probleme që nuk janë zgjidhur për kalimin e rrugës, sidomos për këmbësorët, nxënësit, studentët dhe të moshuarit. Kur shikon kalimin e rrugës nga njerëzit është një dhimbje e madhe, aty automjetet kalojnë me shpejtësi shumë të madhe, gjithëkund në botën përendimore, po thuaj se në çdo vend janë të vendosur semaforët. Duhet të shqyrtohet aty situacioni i terenit me urgjencë, niveli i ujit, kjo punë duhet të realizohet si nga niveli qendrorë, po ashtu edhe ai lokal, deri sa nuk kemi viktima të reja.

Mensur Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kam një pyetje, kur do të asfaltohen rrugët: 'Hamdi Graiçevci' dhe 'Arbëria' në Fushë-Kosovë?

Drejtori për Planifikim Urban: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në lagjen ish/Kolonia ka rrjetë të kanalizimit, kërkesa e atyre banorëve për kyqje në rrjetin e kanalizimit është dërguar në Drejtorinë tonë, por aty qytetarët kanë probleme pronësore të pazgjidhura. Për rrugën 'Xhemajl

Mustafa', është shkëputur kontrata, këtu kemi patur të bëjmë me një nënkontraktorë, i cili ka qenë i pa përgjegjshëm. Rruga për fshatin Miradi të Epërme është në proces gjygjësorë, është një ankesa nga Hekurudha, këtu komuna jonë e ka fituar lëndën në shkallën e parë, tani jemi në shkallën e dytë gjygjësore dhe duhet të presim. Për rregullimin e rrjetit të kanalizimit për familjen Jashari në fshatin Miradi të Epërme, është një largësi shtatë metra gjerësi deri te rruga dhe ju, duhet ta kuptoni se kjo rregullohet me rrugën, tani i kemi disa probleme aty me pynëkryesin, jemi në procedurë, por nëse rrjeti ekzistues ka vetëm mbyllje, kjo punë do të rregullohet ditën e mërkure, për dy ditë nga Kompania përkatëse pynëkryese. Rruga 'Marin Barleti' në fshatin Bardh i Madh duhet të rregullohet, në një gjatësi prej 50 metra. Në rrugën 'Hamdi Grajçevci' në Fushë-Kosovë është në proces ndërtimi i lartë, aty mund të intervenojmë vetëm me zhavor, aty kalojnë kamionët me pesha të rënda mbi tridhjetë tonë, planifikojmë ta asfaltojmë këtë rrugë pas përfundimit të ndërtimeve.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Rruga 'Imer Prizreni' dhe 'Aziz Zhilivoda', janë bërë disa shpurje të saj për rregullimin e trafos dhe ne u kemi dhënë pëlqimin edhe për disa rrugë tjera, në disa raste jemi edhe në procedura gjygjësore. Ndriqimi publik në fshatin Vragoli nuk ka funksionuar për një kohë, tani është rregulluar, edhe në fshatin Harilaç po ashtu është rregulluar tani. Lidhur me shtyllën në rrugë që u cekë nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Naser Grajçevci, do ta shikojmë dhe ky problem do të evitohet, sepse është një rrezik aty dhe pamja paraqitet si e shëmtuar. Për vendosjen e semaforëve në fshatin Miradi të Poshtme, kjo nuk është në kompetencën tonë, por ne i kemi bërë disa shkresa zyrtare për Ministrinë e Infrastrukturës, por kjo punë nuk po ka një epilogë, ne kemi tentuar vitin e kaluar ta vendosim semaforët afër Stacionit të autobusëve, por aty kemi një problem pronësorë, që nuk kemi mundur ta zgjidhim dhe procesi ka dështuar.

Sabri Rexhepi: Semaforët në afërsi të shkollës 'Mihal Grameno' në Fushë-Kosovë, tani janë 23 sekonda, kërkojmë që ata mundësisht të zgjaten në 30 sekonda, sepse prapë ka tollovi në rrugë, e dijmë angazhimin dhe kontributin e juaj për zgjatjen e tyre nga tetë në njëzet e tre sekonda.

Durim Hajra: Projekti për thurjen e rrugës kryesore 'Nënë Tereza' ka patur një ndikim të vogël dhe ka shkaktuar probleme serioze për qytetarët, ne e dijmë se kjo punë është e ndërlikuar dhe në kompetencën të nivelit qendrorë, por duhet të shikohet mundësia për vendosjen e semaforëve dikun afër Çerdhes së Fëmijëve, apo pakë më largë në rrugën kryesore.

Drejtori për Shërbime Publike dhe Mjedis: Vendosja e semaforëve është një procedurë e ndërlikuar dhe varet nga Ministria e Infrastrukturës, por ne do ta rregullojmë aty sinjalistikën, horizontale, zebrat, kjo është mundësia jonë për intervenim. Lidhur me zgjatjen e kohës për semaforin të shkolla, e dijmë këtë problem, ne mund ta parashtrojmë vetëm një kërkesë, por unë mendoj se aty e kemi bërë një zgjidhje të mirë krahasuar me të kaluarën.

Drejtori për Arsim: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Bibloteka e qytetit nuk është në kompetencën e Drejtorisë tonë, është në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, ne biblotekat e shkollave i ndihmojmë vetëm sa i përket furnizimit me libra, por jo edhe për biblotekën e qytetit.

Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Qendra e Mjekësisë Familjare numër 5 është e gatshme, ka mbetur vetëm furnizimi i saj me inventarë, por

ne e kemi problemin me numrin e punëtorëve, kemi ide që një pjesë të personelit dhe laboratorin do ta zhvendosim atje. Ekipet tona mobile i kanë vizituar pacientët, edhe nëpër shtëpi të tyre. Sa i përket gjendjes me Covid - 19 deri me tani i kemi gjithsej 3262 persona të infektuar, prej tyre 2674 janë shëruar, 368 raste janë aktive dhe 38 persona kanë ndërruar jetë.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë e kuptoi se ju po jeni të keqëinformuar në shumë raste, te ne jepen shërbimet shëndetësore të përherëshme, rruga për testimin e pacientëve nga Instituti Kombëtarë për Shëndetin Publik është e njohur si shkonë, kemi ankesa për auto-ambulancën shumë shpeshë, kur shkonë një auto-ambulancë, ne nuk kemi mundësi tjetër, e kemi sqaruar edhe më herët se janë katër mjekë që mirren me pacientët e prekur me Covid - 19 dhe ata përcjellin gjendjen e pacientëve pas hapjes së kartelës.

Shaban Ademi: Unë nuk dua ta përmendi me emër askënd, meqë dua ta ruaj dinjitetin e familjes në fjalë, por ai thotë se për tre ditë nuk i është përgjigjur askush, kjo çka flitni ju është krejt diçka tjetër, por ata thonë se nuk kanë përgjigje, as nga Ekzekutivi i Komunës për ndihmë. Në këtë rast unë nuk e mohoi në asnjë mënyrë angazhimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, për t'iu dalur në ndihmë pacientëve në përgjithësi.

Remzi Shala: Deri tani janë mbi tre mijë pacientë dhe katërqindë raste janë aktive, disa raste kërkojnë trajtim të veçantë, mjeku i kontakton vetëm banorët e komunës tonë.

Aida Alimi: Pyes, kur do të zbatohet vendimi i Kuvendit të Komunës për personat e prekur me Covid - 19, sepse kemi shumë kërkesa nga qytetarët e komunës për këtë çështje.

Naser Graiçevci: Mjetet financiare për menaxhimin e pandemisë kanë qenë jetike, komuna jonë ka ndarë shuma të mëdha të mjeteve financiare në fillim dhe në verë, por prapë nuk janë përkrahur sa duhet qytetarët në një shtrirje kohore më të gjatë, por kjo nuk ka ndodhur, njerëzit janë gjindur ashtu si kanë mundur.

Driton Ademi: Unë i kam dy pyetje, pse bizneset tona nuk janë përkrahur prej 300.00€ deri në 500.00€ sipas vendimit të Kuvendit? Lidhur me këtë e kërkoj një përgjigje për mbledhjen e ardhshme.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Bizneset janë klasifikuar dhe janë ndihmuar me shumën prej: 308,000.00€, disa janë ndihmuar me nga 1300.00€ dhe disa tjera me nga 1,900.00€, sipas kategorizimit të tyre. Shuma prej: 699,000.00€, është përdorur për menaxhimin e pandemisë dhe shuma prej: 302,000.00€, që ka qenë donacion i Bashkimit Evropian për pandeminë, është ndarë për nevojat e qytetarëve, për studentë, njerëzit me sëmundje të ndryshme, ne si komunë nuk i kemi prishur projektet kapitale, por të gjitha shpenzimet për pandeminë i kemi bërë nga kodet për pandeminë 00099 dhe 00098 gjatë vitit 2020.

Pika e tretë (3) - Raporti i Punës për funksionimin e Kuvendit të Komunës për vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Raportin e Punës së funksionimit të Kuvendit të Komunës për vitin 2020', ku të gjithë ne duhet ta kemi parasysh, se kemi vepruar në një vit të pandemisë, që ka qenë një sfidë e madhe për institucionet, familjet dhe shoqërinë në përgjithësi. Në Kuvend janë mbajtur debate konstruktive, para marrjes së secilit vendim. Në muajin mars kemi lejuar mjetet financiare për menaxhimin e pandemisë, për mjetet

financiare për menxhimin e pandemisë është raportuar në mbledhjet e Kuvendit në muajin qershor dy herë, në muajin shtator dhe dhjetor 2020, realizimi i planit të punës në vitin 2020 ka qenë i kënaqshëm, përkundër rrethanave në të cilat kemi vepruar. Hap diskutimin.

Ali Ismaili: E nderuara znj. Kryesuese e Kuvendit të Komunës, ju e potencuatë në diskutimin tuaj vetëm anën pozitive, por jo edhe anën negative, mos zbatimin e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale për publikimin e audioincizimeve të mbledhjeve, mosfunksionimin e Komiteteve Konsultative, për arsim, shëndetësi, bujqësi e tjera, ku sidomos ‘Komiteti për arsim dhe shëndetësi’ në këtë kohë të vështirë për të gjithë, do ndikonin pozitivisht në ofrimin e rekomandimeve për çështje të ndryshme, siç janë: mësimi në distancë, apo mënyrat më efektive për menaxhimin e pandemisë, por këtu komitete nuk janë funksionale për tetë vitë radhazi. Ju i keni modelet e mira të menaxhimit të pandemisë në komunat e Mitrovicës dhe Lipjanit me komunikim të vazhdueshëm me qytetarët. E theksoi me të drejtë edhe anëtari i Kuvendit të Komunës z. Naser Graiçevci, efektin e komunikimit dhe transparencës me qytetarët, ne këtu jemi duke bërë monolog, publiku nuk është i informuar për asgjë lidhur me angazhimin tonë në Kuvendin e Komunës, dhe kjo punë është kështu për tetë vite është njësoi, meqë audioincizimi nuk publikohet. Raportimin që e marrim ne këtu, nuk është i plotë, mungon një raport i mirëfilltë për shpenzimin e 1.2 milion eurove për menaxhimin e pandemisë, mungon një raport për punëtorët e punësuar në projektin e Karitasit, për më shumë se shtatë vite, ne e kërkojmë listën e punëtorëve ajo nuk na jepet, andaj në mungesë të informatave, ne këtu mund të flasim edhe gabimisht, por këtu të nderuarë kolegë, nuk po mundemi ta realizojmë të drejtën e qasjes në informata për punë, projekte publike, sepse materialet nuk janë të plota, përkundër kërkesave të vazhdueshme nga ne si opozitë. Kemi kërkuar që të bëhet edhe dezinfektimi i objekteve fetare: Xhamive dhe Kishave, por kjo punë nuk ka ndodhur gjatë vitit 2020.

Shaban Ademi: Ajo që u tha nga anëtari i Kuvendit të Komunës z. Naser Graiçevci, lidhur me komunikimin, ne e kërkojmë të realizohet nga Ekzekutivi i Komunës dhe Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, nuk kemi çka të shtojmë tjetër, transparenca duhet të bëhet për interesin e qytetarëve.

Naser Graiçevci: Publikimi i ekstrakteve të procesverbaleve bëhet pas aprovimit të tyre, kjo punë është me vonesë për arsye që dihen, për publikun e gjerë duhet të bëhet publikimi i audioincizimeve, njerëzit atë çfarë e themi ne këtu nuk e dinë, nuk është i ditur roli i opozitës në kohën e duhur, këtë opinion publik nuk e dinë, andaj fjalët tona këtu janë monolog.

Driton Ademi: Për të mos i përsëritur fjalët e njëjta, këtu e kemi një raport përshkruar të Kuvendit, nuk kemi asgjë, asnjë fjali për performancën e Kuvendit, sfidat e Kuvendit për vitin 2020, që kemi funksionuar në kohën e pandemisë. Këtu e kemi vetëm një përmbledhje të vendimeve, madje këtu e kemi edhe një vendim refuzues, pyes si ka mundësi që ta kemi këtë vendim të tillë?

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Vlerësimet dhe kritikën e juaja, ne i adresojmë te Ekzekutivi i Komunës.

Doruntina Jashari: Ne këtu e kemi strukturën e punës së realizuar për funksionimin e Kuvendit të Komunës në vitin 2020, por këtu mungon vendimi për realizimin e vizitës zyrtare të anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Shqipëri në vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Kjo vizitë zyrtare është realizuar me ftesë zyrtare të bashkisë së Lezhës në Shqipëri dhe ju të gjithë keni qenë të ftuar, atje jemi pritur nga Kryetari i Bashkisë dhe ne mendojmë, se kjo ka qenë në ndër vizitat më të mira dhe kemi patur një mikëpritje shumë të ngrohtë nga përfaqësuesit e Bashkisë. Raporti i punës e pasqyron, punën dhe aktivitetin tonë për periudhën një vjeçare.

Pika e katërt (4) - Propozim për rritjen e të hyrave vetjake në buxhetin komunal për vitin 2020.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për rritjen e të hyrave vetjake në buxhetin e komunës për vitin 2020’, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Përsëhendes të pranishmit në mbledhje. Propozimi për rritjen e të hyrave vetjake nënkupton, rritjen e buxhetit të komunës për shumën e mjeteve financiare prej: 157,692.45€, mbi shumën e planifikuar prej: 2,077,613.77€ ose një rritje e të hyrave vetjake prej: 5.5%. Propozimi në fjalë është sistemuar për shpenzim në këto kode ekonomike të programeve: shuma e mjeteve financiare prej: 10,000.00€ është e destinuar për pagesën e zjarrëfiksëve, sipas Memorandumit të Bashkëpunimit me Agjencinë për Menaxhimin e Emërgjencave, kjo shumë ka qenë e paplanifikuar për shpenzim në vitin 2020. Shuma tjetër prej: 100,000.00€ është në shëndetësi, ku prej tyre 60,000.00€ janë të destinuara për zbatimin e vendimit të Kuvendit të Komunës, për harmonizimin e pagave të punëtorëve shëndetësorë të punësuar në projektin e Karitasit, për të patur paga të përafërta me punëtorët tjerë shëndetësorë, ndërsa shuma tjetër e mbetur prej: 40,000.00€ do të shpenzohen për menaxhimin e pandemisë. Shuma e mbetur prej: 47,692.45€ do të shpenzohen në arsim, për zëvendësimet e mësimdhënësve dhe çështje tjera në fushën e arsimit sipas nevojave. Këtu shuma të mjeteve financiare janë të inkuorpuara në tabelën e barjes së mjeteve financiare të pashpenzuara në vitin 2020, për shpenzim në vitin 2021.

Durim Hajra: Në parim ne nuk jemi kundër rritjes së buxhetit nga të hyrat vetjake, ku një pjesë e këtyre mjeteve financiare, do të shpenzohen për harmonizimin e përafërt të pagave të punëtorëve shëndetësorë të punësuar në projektin e Karitasit për vitin 2021. Ne si Kuvend i Komunës, nuk e kemi një raport të detajizuar financiarë për shpenzimin e 1.2 milion eurove, për menaxhimin e pandemisë Covid - 19 gjatë vitit 2020. Shpenzimin e këtyre mjeteve financiare gjatë vitit 2020 në një situatë të vështirë, dikush nuk e ka ndierë fare, dikush e ka tepëruar dhe në këtë kontekst nuk ka barazi fare, ne besojmë që fatin e njëjtë do ta kenë edhe këto mjete financiare, që janë tejkallim i buxhetit nga të hyrat vetjake, me përjashtim të shumës prej: 60,000.00€ që janë të dedikuara për punëtorët në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë.

Driton Ademi: Rritja e shumës së mjeteve financiare në buxhet prej: 157,692.45€, ne e kuptojmë që është realizuar në tremujorin e katërt dhe nuk mund të shpenzohet, mirëpo ne e kontestojmë procedurën e kërkuar për realizim nga ana juaj, kjo mund të bëhet vetëm në kuadër të rishikimit të buxhetit. Memorandumin e mirëkuptimit për zjarrëfikës, ne nuk e kemi në material, kontratën e prokurimit për punëtorët shëndetësorë nuk e kemi, nuk e kemi asnjë specifikim për shpenzimin e 47,692.45€ në arsim dhe asnjë specifikim për shpenzimin e 40,000.00€ në shëndetësi. Bartjet e

mjeteve financiare duhet të bëhen sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore, këtu drejtoritë e komunës nuk pyeten fare për shpërndarjen e mjeteve financiare, këtë e ka pohuar vetë në mbledhjen e Kuvendit drejtori për Arsim, kjo lëvizje e mjeteve financiare nëse bëhet në këtë formë është shkelje e procedurave.

Nënkryetari i Komunës: E para tejkalimi i buxhetit është shpërndarë nëpër pozicionet e nevojshme. Drejtoria e Financave dhe Buxhetit në kordinim edhe me nevojat e drejtorive tjera, e ka propozuar për aprovim këtë shpërndarje të mjeteve financiare. Ne i kemi disa obligime financiare, që do t'i përmbushim me këtë rritje të buxhetit, këtë procedurë të ri-orientimit dhe strukturimit të buxhetit, nuk e konteston asnjëherë Ministria e Financave, sepse rregullat janë të vendosura nga Kuvendi i Kosovës.

Driton Ademi: Me grantet qeveritare mjetet financiare të parapara në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve, barten sipas sistemimit të tyre. Ju e keni shumicën në Kuvendin e Komunës dhe mund ta kaloni këtë propozim, por kjo mund të vendoset vetëm me rishikimin e buxhetit, për ndryshe është pjesë e paplanifikuar dhe paraqet shkelje në procedurë.

Nënkryetari i Komunës: Shuma prej: 777,163.43€ janë mjete financiare të kontraktuara, nëse ato nuk barten projektet publike mbesin të pa realizuara, ndërsa mjetet financiare që paraqesin tejkalim të buxhetit, ne i kemi shpërndarë për shpenzim në tre pozicione në kuadër të Drejtorive të ndryshme komunale.

Driton Ademi: Këtu kemi të bëjmë me një shpërndarje sociale të buxhetit në shumë prej 2,077,613.77€, ku lista e këtyre projekteve publike krijon dyshime për rezultatin zgjedhor brenda këtij viti.

Ali Ismaili: Shuma e mjeteve financiare prej: 60,000.00€ që ndahet për harmonizimin dhe përafrimin e pagave të punëtorëve shëndetësorë të Karitasit, është korrekte, por për shumën e mjeteve financiare prej: 40,000.00€ në shëndetësi nuk ka asnjë detajizim të shpenzimeve, njësoi siç nuk kemi një llogaridhënie të detajizuar për shpenzimin e 1.2 milion eurove në subvencione dhe mallëra e shërbime gjatë vitit të kaluar, për ndihma ushqimore, dezinfektime të objekteve, blerje të pajisjeve shëndetësore dhe subvencione për biznese. Nënshkrimi i memorandumit për zjarrëfikës është akt i kryerë, zëvendësimet në arsim kanë ndodhur dhe do të ndodhin prapë, jemi ende në pandemi, në shëndetësi kërkesë e jona është që barnatorja e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, të funksionon edhe pas orës 15:00h, sepse njërëzitet sëmuren edhe pasdite dhe kanë nevojë për barna në këtë kohë të vështirë. Pa një specifikim të qartë të shpenzimeve ne nuk mund ta aprovojme propozimin në fjalë.

Aida Alimi: Në parim ne jemi për aprovimin e propozimit për rritjen e të hyrave vetjake në buxhet, sepse kjo është një punë e mirë dhe shkon në interesin publik të qytetarëve. Pyes, shuma e mjeteve financiare prej: 40,000.00€ në shëndetësi, a do të përdoret për të sëmuarit me Covid - 19?

Migjen Kolshi: Këtu Nënkryetari i Komunës foli shumë, por mua nuk më dha asnjë përgjigje të saktë. Unë propozoi që nga shuma e mjeteve financiare prej: 40,000.00€ në shëndetësi, shuma prej: 20,000.00€ të ndahen për blerjen e shtretërve, për nevojat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, ky është propozimi im.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Unë pajtohem me propozimin në fjalë dhe kërkoi nga ju, që për mjetet financiare që janë tejkalim në buxhet, të jepni propozime konkrete.

Ali Ismaili: Unë mendoi se kjo është ideja kryesore, që mjetet financiare që i kemi në dispozicion, t'i ndajmë nëpër vende, aty ku ka më së shumti nevojë, por ne nuk po kemi material të zgjeruar nga Drejtoritë përkatëse, për nevojat më urgjente për shpenzimin e buxhetit.

Remzi Shala: Kuptohet në shëndetësinë tonë primare, këta shtretër janë përdorur, kemi nevojë për një kontraktim të tillë, edhe për Qendrën e re të Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë. Por përveq-kësaj ne kemi problem më të madh me resurset njerëzore.

Driton Ademi: Blerja e shtretërve të ri dhe inventarit duhet ta ketë një arsyeshmëri, të dihet ku përfundojnë këto investime, sepse mjete financiare për këto punë janë ndarë shumë edhe në vitet e kaluara.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Ne këto mjete financiare do të mund të fillojmë t'i shpenzojmë në fund të marsit, ose në fillim të prillit, t'i fillojmë procedurat e parapara dhe t'i realizojmë këto projekte konkrete.

Mehdi Lahu: Drejtorja për Financa dhe Buxhet nuk është konsultuar si duhet me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, për t'i vendosur saktë kërkesat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë në këtë tejkalim të buxhetit. Nuk janë të specifikuar kërkesat as për emergjencën, as për nevojat tjera në shëndetësi.

Migjen Kolshi: Unë e propozova këtë shumë, meqë e kam parë vetë se ka nevojë për shtretër të ri, por nuk kam njohuri për q-mimet sa kushtojnë këta shtretër për shëndetësinë tonë primare.

Durim Hajra: Atë që e tha anëtari i Kuvendit të Komunës z. Driton Ademi qëndron, ne nuk kemi sqarime as për shpenzime të këtyre mjeteve financiare, as nuk jemi në rregull me aspektin procedural, këtu nuk shkohet me tahmin të nderuarë, cila është siguria se shtretërit kushtojnë njëzet mijë euro, e jo pesëmbëdhjetë mijë euro, këtë nuk mund ta definojmë ne kështu aty për aty, pa asnjë arsyetim.

Migjen Kolshi: Unë këtu nuk ndava mjete financiare, vetëm e dhashë një propozim konkretë, që është nevojë për Qendrën tonë shëndetësore

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Ne e kemi një tejkalim prej: 157,692.45€, ne si Ekzekutiv i Komunës e kemi dhënë propozimin tonë për shpërndarje, ju si anëtarë të Kuvendit të Komunës jeni të thirrur të jepni propozime, për ridestinimin e këtyre mjeteve financiare, nëse nuk pajtoheni me këtë shpërndarje.

Sabit Bullatovci: Unë mendoi se është dhimbje të bisedohet një orë në këtë mënyrë, pa asnjë propozim apo vlerësim të përgjegjshëm, për shpërndarjen e këtyre mjeteve financiare, këto janë mjete financiare të taksapaguesëve tonë. Rregullimi i hapësirave në objektin shëndetësorë, banjove, vendosja e shtretërve dhe pajisjeve tjera, duhet të jetë e planifikuar më herët, është për dhimbje mënyra e trajtimit të shëndetësisë kështu edhe nga ju. Ju këtu po theksoni fjalë kotë, se po keqpërdoren mjetet financiare, kjo s'ka munësi të ndodh, buxheti auditohet në secilin vitë, pse po flisni kotë pa asnjë argumentë këtu, nëse keni prova flisni aty ku duhet.

Driton Ademi: Diskutimi i anëtarit të Kuvendit të Komunës, kolegut tonë z. Sabit Bullatovci, për hirarkinë e institucioneve lartë-poshtë dhe poshtë-lartë, ne këtu jemi Kuvend dhe kohë pas kohe

doktor Remi, ka ngritur disa shqetësime dhe ka paraqitur nevojat për investime dhe mungesën e personelit mjekësorë, me kontrata të rregullta të punës në Qendrën shëndetësore, andaj ne i ngrisim këto çështje dhe kërkojmë zgjidhje.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim ‘Propozimin për rritjen e të hyrave vetjake në buxhetin e komunës për vitin 2020’, me ndryshimin që shuma prej: 20,000.00€ në shëndetësi, të mbetet për menaxhimin e nevojave të krijuara me situatën pandemike Covid - 19 dhe shuma prej: 20,000.00€, të ndahet për blerjen dhe furnizimin me shtretër për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë.

U votua me: tetëmbëdhjetë vota ‘për’, dy ‘kundër’ dhe një abstenim, gjithsej njëzet e një anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi ‘Propozimin për rritjen e të hyrave vetjake në buxhetin e komunës për vitin 2020’, me ndryshimin që shuma prej: 20,000.00€ në shëndetësi, të mbetet për menaxhimin e nevojave të krijuara me situatën pandemike Covid - 19 dhe shuma prej: 20,000.00€, të ndahet për blerjen dhe furnizimin me shtretër për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë dhe mori:

V E N D I M

1. Për rritjen e të hyrave vetjake për vitin fiskal 2020, në shumën prej 157,692.45€, të shpërndara nëpër kategoritë ekonomike të pagave dhe mëditjeve dhe mallrave e shërbimeve nëpër kodet e programeve, nënprogrameve si në vijim:
 - 1.1 Mjetet financiare në shumë prej 10,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike për paga dhe shtesa - 11, në programin Shërbimet e Zjarrëfiksëve 18210, për pagesën e rritjes së koeficientëve sipas memorandumit për zjarrëfikës;
 - 1.2 Mjetet financiare në shumë prej 100,000.00€, lejohen për shpenzim në kategorinë ekonomike mallëra dhe shërbime - 13, programi Administrata e Shëndetësisë 73011, me këtë shpërndarje.
 - 1.2.1 Mjetet financiare të propozuara për shpenzim në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 destinohen, shuma prej: 60,000.00€ për harmonizimin e përafërtë të pagave të punëtorëve shëndetësorë - mjekëve, infermereve dhe stafit mbështetës të Karitasit, shuma prej: 20,000.00€ për menaxhimin e nevojave të krijuara me situatën pandemike Covid - 19 dhe shuma prej: 20,000.00€ për blerjen dhe furnizimin me shtretër për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare ‘Dr. Fatmir Krasniqi’ në Fushë-Kosovë.

Pika e pestë (5) - Propozim për bartjen e mjeteve financiare të pashpenzuara të vitit 2020, për shpenzim në vitin 2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për bartjen e mjeteve financiare të pashpenzuara të vitit 2020, për shpenzim në vitin 2021’, ftoi Drejtorin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet që të na jap sqarime.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Për arsye të debatit dhe transparencës së buxhetit, ne i kemi shpërndarë dhe bartur mjetet financiare të pashpenzuara në vitin 2020, në buxhetin e vitit 2021 për shpenzim, me sqarime konkrete për secilin program dhe projekt publik. Këto mjete financiare në shumë prej: 3,023,613.65€ janë nga fondi burimorë 21 dhe 22, kur kësaj shume i hiqen mjetet financiare të kontraktuara për projekte kapitale në shumë prej: 777,163.43€, që nuk kanë mundur të kryhen dhe shuma e mjeteve financiare prej: 157,692.45€ nga rritja e të hyrave vetjake, atëherë mbesin 2,077,613.77€.

Durim Hajra: Këtu shtrohet një pyetje legjitime, ku nga buxheti i komunës prej: 11,000,000.00€, mbesin të pa shpenzuara dhe kërkohet të bartet në vitin vijues, shuma e mjeteve financiare prej: 3,000,000.00€, kjo paraqet 20% të totalit të buxhetit, kur shumë projekte në interesin e qytetarëve kanë mbetur të pa realizuara, kjo nuk don komentë fare, kjo i bjen që ju si Ekzekutiv i Komunës e keni huqur me planifikimin e buxhetit.

Drejtori për Financa dhe Buxhet: Ju e dini se zotimet e fundit për projekte kapitale bëhen vetëm deri me datën 30 tetor, në muajin nëntor dhe dhjetor nuk mund të shpallim asnjë procedurë të tenderimit, kjo është kështu që Organizatat Buxhetore të mos punojnë në kohën e dimrit. Kur kjo punë analizohet në mënyrën e drejtë, projektet e kontraktuara dhe mjetet financiare të grumbulluara në muajin nëntor dhe dhjetor, atëherë kjo shumë zbret në 30%, të shumës që bartet dhe kjo mund të arsyetohet, por ju nuk po e shqyrtoni drejtë propozimin në fjalë.

Mehdi Lahu: Bartja e madhe e mjeteve financiare, tregon për një keqëmenaxhim të buxhetit, në këtë vitë kemi qenë edhe në pandemi, por janë realizuar projekte të caktuara në infrastrukturë, edhe përkundër rënies ekonomike. Janë ndërtuar ura të ndryshme, rregullimi i përrockave, por jo në mënyrën adekuate, ku prapë kemi patur vërshime të mëdha dhe shumë dëme nëpër shtëpi të banimit.

Driton Ademi: Buxheti i komunës nuk duhet të ketë, as suficitë, as deficit, në të dy rastet kemi të bëjmë me keqëqeverisjen e buxhetit. Buxheti nënkupton planifikimin e mirë të tij dhe zbatimin me përpikëri të asaj që e planifikon, jo ndryshimin e tij për tre million euro, unë këtu plotësisht pajtohem me mendimin e Durimit që kur buxheti shpenzohet në këtë mënyrë, nuk keni as çfarë të thoni, as çfarë të propozoni.

Migjen Kolshi: E para për secilin vitë kemi një bartje shumë të madhe të buxhetit, më herët ka qenë 2 milion euro, tani kjo shumë ka arritur në 3 milion euro, por ky është një menaxhim i mirë i buxhetit në aspektin elektoral, sepse këtë vitë pushteti ka në dispozicion më shumë mjete financiare për shpenzim dhe në këtë mënyrë blihen votat, në mandatin tjetër këtë shumë do ta keni të përgjysmuar, në vetëm 1.5 milion euro.

Aida Alimi: Unë përveç planifikimit jo të mirë të buxhetit, dyshoi edhe në mbikëqyrjen jo adekuate të projekteve publike, andaj unë jam kundër kësaj shume kaq të madhe për bartjen e mjeteve financiare të pashpenzuara nga viti paraprakë në këtë vitë.

Nënkryetari i Komunës: Këtu Drejtori për Financa dhe Buxhet e sqaroi, pse ka mbetur kjo shumë e mjeteve financiare e pashpenzuar. Procedurat e tenderimeve shpeshherë zgjatin shumë, me ankesa edhe në Organin Shqyrtues të Prokurimit. Për çdo vitë kemi tejkalim të buxhetit për rreth 600,000.00€, që zakonisht grumbullohen në dy muajt e fundit të vitit. Kjo mbetje e buxhetit i ka

dy të mira, sepse ne ende jemi në pandemi dhe kjo nuk dihet, as kur do të përfundon dhe një pjesë tyre janë për realizimin e projekteve publike, që nuk kanë përfunduar.

Ali Ismaili: Lidhur me pikën paraprake unë pajtohem pjesërisht me Nënkryetarin e Komunës, por jo tani, sepse kjo bartje po ndodh po thuaj se për tetë vite. Nuk ka asnjë analizë profesionale për strukturimin e shpenzimeve, uljen e mbetjeve të pa arsyeshme, caktimin e tavanit për shpenzime nëpër secilin sektorë publikë. Këto mjete financiare është dashur të shpenzohen dhe mbetjet të zvogëlohen në minimumin e arsyeshëm, e jo të shkojnë duke u rritur nga viti në vitë.

Driton Ademi: Platëforma për shpenzimin e buxhetit dhe realizimin e projekteve publike, duhet të zhvillohet gjatë muajve maj-shtator, ajo nuk duhet të lihet për fundin e vitit.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2020, për shpenzim në vitin 2021'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për', nëntë 'kundër' dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për bartjen e mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të vitit 2020, për shpenzim në vitin 2021' dhe mori:

V E N D I M

1. Lejohet bartja e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetjake të vitit fiskal 2020, në vitin fiskal 2021 në shumë të përgjithshme prej 3,023,613.65€, sipas propozimit me dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 153, të datës 15.02.2021.
2. Bartja e mjeteve financiare nga të hyrave vetjake të pa shpenzuara është për kategoritë ekonomike të shpenzimeve si vijon:
 - 2.1 Për kategorinë ekonomike paga dhe mëditje shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 10,000.00€;
 - 2.2 Për kategorinë ekonomike mallra e shërbime shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 147,692.45€;
 - 2.3 Për kategorinë ekonomike shpenzime për komunalitet shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 3,118.94€;
 - 2.4 Për kategorinë ekonomike subvencione shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 44,239.21€;
 - 2.5 Për kategorinë ekonomike investime kapitale shuma e përgjithshme e mjeteve financiare është 2,818,563.05€.

Pika e gjashtë (6) - Shqyrtimi i dytë i 'Propozimit për taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënitit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës për vitin 2021'.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: Tani ne e kemi në shqyrtimin e dytë 'Propozimin për taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënitit dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës për vitin 2021', pa ndryshime, ftoi Drejtorin e Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

Drejtori për Planifikim Urban: Unë e kam sqaruar një gabim teknik në propozim në shqyrtimin e parë, shuma është e rritur dhe tani është 6.94€, ju ftoi që ta aprovonit propozimin në fjalë.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për miratim ‘Propozimin për taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënitit dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës për vitin 2021’.

U votua unanimitet nga të pranishmit, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e miraton: ‘Propozimin për taksat administrative për lëshimin e lejeve të ndërtimit, lejeve të rrënitit dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës për vitin 2021’ dhe mori:

V E N D I M

1. Për miratimin e Propozimit Nr. 472, të datës 04.12.2020 për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënitit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2021 si vijon:
 - 1.1 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.55€ për një metër katror në kategorinë e parë;
 - 1.2 Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 2.10€ për një metër katror në kategorinë e dytë;
 - 1.3 Taksa administrative për leje të rrënitit në shumë prej 0.95€ për një metër katror;
 - 1.4 Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë në shumë prej 4.84€ për një metër katror.
2. Miratimi i taksave administrative dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë për vitin 2021, mbështetet në shkresën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit Nr. 4639-2/20, të datës 24.11.2019.

Pika e shtatë (7) - Shqyrtimi i kërkesës për rishqyrtimin e vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sipas shkresës Nr. 020-995/5, të datës 09.02.2021.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim kërkesën për rishqyrtimin e vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sipas shkresës Nr. 020-995/5, të datës 09.02.2021’, ftoi Drejtorin e Planifikimit Urban që të na jap sqarime.

Drejtori për Planifikim Urban: Sqaroi se vendimi duhet të përmirësohet në dy pika, në preambulë dhe te afati kohorë për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal.

Pas sqarimeve, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës e qiti në votim për miratim ‘Propozimin për rishqyrtimin e vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sipas shkresës Nr. 020-995/5, të datës 09.02.2021’.

U votua unanimitet nga të pranishmit, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesja e Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet të votave e aprovoi ‘Propozimin për rishqyrtimin e vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal sipas shkresës Nr. 020-995/5, të datës 09.02.2021’ dhe mori:

V E N D I M

Për rishqyrtimin e vendimit Nr. 176, të 16.12.2020 për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal të Fushë-Kosovës

Pika e tetë (8) - Të ndryshme.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës: E kemi pikën 'Të ndryshme', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që të marrin fjalën, nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Migjen Kolshi: Unë edhe njëherë dua ta ceku këtu mungesën e fotografisë së Komandantit legjendarë 'Adem Jashari', në sallën e Kuvendit të Komunës, këtë fotografi nëse ju nuk e vendosni, unë do ta blejë kontributin tim.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në ora 12:30 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesja e Kuvendit të Komunës

Vjollca Konjusha

